



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "PEVLAKU" për aktivitetin: "Tregu I ri I qytetit" dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "PEVLAKU" e datës 13.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu I ri I qytetit" dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 12.11.2020.

.....

3. Ky vendim i korigjuar hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PEVLAKU" me datë 13.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Tregu i ri i qytetit**", dhe me numer të prokurimit 616 19 29 511

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.11.2020 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Shumica e pretendimeve nga kërkesa janë trajtuar edhe me pare duke përfshirë edhe dëshmitë profesionale për inxhinierin e elektros dhe të makinerisë. Megjithatë të njëjtat i kam percjellur edhe të komisioni për rivlerësim dhe konstatimet e tyre janë cekur në raportin e rivlerësimit.

Bazuar në faktin se konstatimet janë bërë nga një ekip profesional, përgatitja ime profesionale me pamundëson që të paraqes një koment meritore lidhur me këtë dhe kjo edhe është arsyeja pse e kam aprovuar rekomandimin e tyre.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njësisë së kërkesës.

Zekë Bardhaj

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

